

Disiplina/ Mbyllen dyert e Loro Boricit per tifozet

nga AlbaniaSoccer

E mërkurë, 09 Tetor 2013 16:40



Vllaznia do te luaj dy ndeshjet e ardhshme pa tifozet. Ky eshte vendimi qe ka marre sot Komisioni i Disiplines prane Federates Shqiptare te Futbollit ne mbledhjen e tij te radhes. Gjithçka ka ndodhur pas incidentit te krijuar me futbollistin e Skenderbeut Gjergj Muzaka pas shenimit te golit te trete per skuadren e tij. Ai ne vend qe te shkonte e te gezohej me tifozet korçare te pranishem ne stadium, ka festuar tek tifozet ultras te Vllaznise. Me pas ata kane reaguar duke hedhur ne fushe sende te forta dhe tani kuqebllute do te luajne te denuar dy ndeshje ne Loro Borici por pa pranine e tifozeve.